

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga NLB Skladi, menaxhim i mjeteve, d.o.o. (**NLB Skladi, upravljanje premoženja, d.o.o.**), me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjana, Slloveni, i dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Polenak nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 21.12.2023, merr këtë

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me anë të së cilit NLB Skladi, menaxhim i mjeteve, d.o.o. (NLB Skladi, upravljanje premoženja, d.o.o.), me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjana, Slloveni, synon të fitojë kontroll të pavarur drejtpërdrejt mbi Shoqërinë për menaxhimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura të investimeve GENERALI INVESTMENTS SHA Shkup, me seli në bul. Partizanski odredi nr. 14A/1-2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më 27.11.2023, ndërsa e plotësuar më 28.11.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga NLB Skladi, menaxhim i mjeteve, d.o.o. (NLB Skladi, upravljanje premoženja, d.o.o.), me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjana, Slloveni, me anë të së cilit

NLB Skladi, menaxhim i mjeteve, d.o.o. Lubjana, Slloveni synon të fitojë kontroll të pavarur drejtpërdrejt mbi Shoqërinë për menaxhimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura të investimeve GENERALI INVESTMENTS SHA Shkup, me seli në bul. Partizanski odredi nr. 14A/1-2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

NLB Skladi është pjesë e Grupit NLB. Grupi NLB është një grup bankar dhe financiar lider me seli dhe interes strategjik ekskluziv në rajonin e tij të origjinës - Evropën Juglindore. Përveç NLB d.d., e cila është subjekt kryesor në Slloveni dhe një ndërmarrje publike. Grupi NLB përbëhet nga disa shoqëri të lidhura: gjashtë banka dhe disa shoqëri për shërbime të tjera financiare dhe ndihmëse (menaxhimi i aseteve, lizing, menaxhim i pasurive të paluajtshme, etj.) .

Grupi NLB përdor një model bankar universal dhe mbështet klientët e saj përmes shërbimeve bankare për shitje me pakicë, korporata dhe investime.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi NLB ka dy shoqëri të lidhura të regjistruara:

- (1) NLB Banka SHA Shkup, me seli në rr. Vodnjanska nr. 1, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, me aktivitet prioritar të regjistruar 06.1 – bankë; dhe
- (2) Shoqëria e lizingut NLB LEASE&GO SHPK Shkup me seli në rr. Vodnjanska nr.1, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, me aktivitet prioritar të regjistruar 64.91 - Lizing financiar dhe 77.11 dhënie dhe marrje me qira (lizing) të veturave dhe mjeteve motorike të kategorisë së lehtë.

Aktiviteti i regjistruar prioritar i Generali Investments SHA Shkup është 66.30 - Veprimtaritë e menaxhimit të fondeve.

Generali Investments SHA Shkup ka licencë të lëshuar nga Komisioni për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për funksionimin e një shoqërie për menaxhimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura investuese në përputhje me Ligjin për fondet investive.

Generali Investments SHA Shkup menaxhon katër (4) fonde investuese:

- Generali Amerika;
- Generali BRIK;
- Depozitat Generali Kesh;
- Generali Top Brands

Generali Investments SHA Shkup gjithashtu ka leje nga KLV-ja në përputhje me Ligjin për Fondet e Investimeve për kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme: (i) punë në menaxhimin e aseteve për llogari të një klienti individual - pronar i një portofoli dhe (ii) punë në këshillim investimi për klientët.

Fondet e Generali Investments SHA Shkup investojnë në klasa të ndryshme të investimeve si instrumente me të ardhura fikse, depozita, aksione në tregjet globale në disa industri të ndryshme.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски